

NJOFTIME FITUESI ANKANDI

BASHKIA ELBASAN NJOFTIM FITUESI ANKANDI

Për:

OE "Agron Muça"

" Agron Muça " sh.p.k me L72707203A, me adresë: Fshati Pashtresh, Njësia Administrative Gjinar, Elbasan.

Procedura e ankandit: "Ankand i Hapur".

Përshkrim i shkurtër i procedurës së ankandit dhe objektit të tij: Shitje material drusor në këmbë, për sasinë totale prej 823 (tetëqind e njëzet e tre) m³, me vlerë fillestare 1,231,350 (njëmiljon e dyqind e tridhjet e njëmijë e treqind e pesëdhjetë) lekë, me afat nga data e lidhjes së kontratës, 16 (gjashtëmbëdhjet) muaj.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data 20/7/2026] [Nr. 46]. Njoftojmë se në këtë procedurë të zhvilluar më datë 11.08.2026 ora 10.00, kanë qenë pjesëmarrës këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. OE "Agron Muça" me NIPT: L72707203A.

Vlera e ofruar është 1,255,977 (njëmiljon e dyqind e pesëdhjet e pesë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë.

Ofertues të s'kualifikuar nuk ka.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: OE "Agron Muça" me NIPT: L72707203A, me adresë: Fshati Pashtresh, Njësia Administrative Gjinar, Elbasan; se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 1,255,977 (njëmiljon e dyqind e pesëdhjet e pesë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë. është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Elbasan, me adresë: rruga "Qemal Stafa", Elbasan, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga shpallja në Buletinin e Njoftimeve Publike, siç parashikohet në dokumentat e ankandit.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 39 të ligjit nr. 9874, date 14.02.2008 "Për ankandin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 11.8.2026.